



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 433/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi- Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani -Referuese, Kimete Gashi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "TERMOMONTIMI SH.P.K", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", 4 Lote", me nr. të prokurimit: 616-22-2660-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMUNA E PRISHTINËS, me datën 15.11.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

I **APROVOHET** e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "TERMOMONTIMI SH.P.K" e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 05.09.2022 me numër të protokollit 433/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit për ndriçimin publik", 4 Lote", me nr. të prokurimit: 616-22-2660-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PRISHTINËS.

II. **ANULOHET** Vendimi i AK për aktivitetin prokurimit të precizuar si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Ri-vlerësim.**

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e OE ankues aprovet e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

Me datën 15. 08. 2022, AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës sa i përket aktivitetit të prokurimit, ndaj të cilit OE “TERMOMONTIMI SH.P.K”, me 22.08.2022 ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar nga AK.

Me 05.09.2022 OE “TERMOMONTIMI SH.P.K”, ka parashtruar ankesë me (Nr. protokollit: 433/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 26.09.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Urdhërohet Autoritetit Kontraktues që aktivitetin e prokurimit ta kthej në Ri-vlerësim;

### **Përgjigje në pretendimet ankimore**

OE ankues “Termomontimi SH.P.K.” në Ankesën me numër P.SH. 433/22, pretendon së gjatë udhëheqjes se këtij aktiviteti të prokurimit publik AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në rregullën 57 dhe RRUOPP, konkretisht me: Nenet: 52, 59, 61 dhe 69 të LPP-së; nenet 30.4 dhe 41 të RRUOPP; Rregullën B57 për tenderët jo normalisht të ulët, neni 4 Procedura e shqyrtimit (inter partes) dhe 85. *08.06.2021 A zbatohet neni 61 i LPP-së dhe “Rregullat për çmime jo-normalisht të ulëta” edhe në rastin e kontratave “me çmime njësi” sipas nenit 56.15 të RRUOPP, si dhe a nuind të kërkohe s qarime nga OE edhe për pozicione jo normalisht të ulëta?*

Pretendimet ankimore të OE ankues janë të aspektit administrativ dhe tek plotësimi i kërkesave teknike dhe profesionale, të drejtuara ndaj ofertave të OE dhe GOE që janë propozuar për tu shpërblyer me kontratë për të 4 Lot-et.

AK për secilin Lot (specifikacionet teknike) i ka ndarë në **Pjesën A** të cilën e ka poentuar me **70%** dhe në **pjesën B** që e ka poentuar me **30%**, pra për të përzgjedhur ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë, AK ka përdorur kalkulimin në bazë të **“çmimit të përgjithshëm të peshuar”**.

Eksperti shqyrtues i prokurimit mendon që gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteti të prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me nenet: 52, 59 dhe 69, por në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe dokumentit B57: Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Neni 4 - Procedura e shqyrtimit (inter partes). Për këtë arsye propozoj Paneli Shqyrtues të sjellë vendim për obligim të AK-së që aktiviteti të kthehet në rivlerësim dhe rivlerësimi të behët konform nenit 61 të LPP-së, ashtu që nëse dokumentohet arsyeshmëria atëherë do të arrihej shfrytëzimi i fondeve publike në përputhje me qëllimet e parapara në nenet 1 dhe 6 të LPP-së.

#### Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “TERMOMONTIMI SH.P.K”, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç’rast OE “TERMOMONTIMI SH.P.K”, është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues. AK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Me datën 08.11.2022 u mbajt seanca e shqyrtimit kryesor në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK si dhe eksperti shqyrtues.

**Paneli shqyrtues sqaron**, se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në **nenin 6 të LPP-së**, autoriteti kontraktues duhet të këtë në konsideratë edhe **nenin 1 të LPP-së**, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

#### Paneli shqyrtues për pretendimet ankimore të OE ankues për OE “Elektrika Mont SHPK”:

Pretendimin lidhur për marrëveshjet për angazhim dhe kontratave të noterizuara për stafin e ofruar PSH e klasifikon të pa bazuar sepse AK ka lënë dy mundësi dhe këto kontrata të stafit të ofruara mund të hyjnë në kuadër të marrëveshjeve për angazhim sepse nuk mund të hedhën si jo të tilla sepse i përmbajnë të gjitha elementet e një marrëveshjeje, përfshirë edhe titullin e aktivitetit për të cilin është lidh kjo kontratë.

Pretendimin lidhur për punëtorët teknik, PSH e klasifikon si të pa bazuar sepse AK sa i përket punëtorëve teknik nuk e precizon kategorizimin e tyre dhe si e tillë është gjithëpërfshirëse, PSH e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues se kjo kërkesë nga OE është plotësuar.

Pretendimin lidhur se OE “Elektro Mont SHPK”, nuk ka dorëzuar garancion të nënshkruar nga ana e tij, PSH e ka verifikuar se ky garancion nuk është nënshkruar nga ana e tij por nga ana e prodhuesit, por PSH konstaton se si kriter është përmbushur sepse garancioni i prodhuesi është brenda ofertës së OE ofertues dhe njëherit duhet të llogaritet si garancion i kësaj oferte. AK këtë garancion e ka vendosur edhe tek Kushtet e Veçanta të Kontratës, konform nenit 18 të RRUOPP, Kushtet e veçanta duhet të plotësohet nga Zyrtari i Prokurimit ne kohen e përgatitjes se Dosjes se Tenderit të cilat duhet të jenë pjesë e kontratës së nënshkruar nga palët.

Pretendimin lidhur se OE “Elektro Mont SHPK”, në ofertën e tij në shumicën e pozicioneve ka ofruar çmime manipulative dhe që nuk përkojnë me realitetin dhe çmimin në treg, PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar dhe konstaton se AK nuk ka zbatuar në përpikëri dispozitat e nenit 61 të LPP-së, në të cilën specifikohen rrugët të cilat duhet ti ndjek një AK, nëse konstaton se ka pranuar ndonjë ofertë e cila përmban çmim jo-normalisht të ulët:

*“1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.*

*2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:*

*2.1. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;*

*2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;*

*2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose*

*2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.”*

Paneli shqyrtues për pretendimet ankimore të OE ankues për OE “Everlight SHPK & ITE Engineering SHPK”;

Pretendimi lidhur me ate se mungon Diploma për punëtorët teknik, PSH e klasifikon si të pabazuar sepse për plotësimin e kërkesës nr.2 tek kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar dëshmia: “CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt. Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit për udhëheqësin e punishtes. Marrëveshjet mbi angazhimin e tyre apo kontratat e noterizuara për punëtorët teknik dhe fizik”. Pra, PSH konstaton se CV dhe Diploma është kërkuar vetëm për udhëheqësin e punishtes dhe jo për punëtorët teknik. Andaj, kjo kërkesë është plotësuar konform DT nga OE “Everlight SHPK & ITE Engineering SHPK”.

Pretendimin lidhur se OE “Everlight SHPK & ITE Engineering SHPK”, në ofertën e tij në shumicën e pozicioneve ka ofruar çmime manipulative dhe që nuk përkojnë me realitetin dhe

çmimin në treg, PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar dhe konstaton se AK nuk ka zbatuar në përpikëri dispozitat e nenit 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues për pretendimet ankimore të OE ankues për OE “N.SH. M.V.R Elektromontuesi & NNP Elektro”:

Pretendimin lidhur për marrëveshjet për angazhim dhe kontratave të noterizuara për stafin e ofruar PSH e klasifikon të pa bazuar dhe ky OE i ka dorëzuar dokumentet konform kërkesës së vendosur tek FDT.

Pretendimin lidhur për kualifikimet shkollore, PSH e klasifikon si të pa bazuar dhe i mbështet arsyetimet e ekspertit për këtë pretendim dhe konsideron se OE në përputhje të plotë me kërkesat në FDT dokumentacionin dhe dëshmitë për stafin profesional dhe të pakualifikuar.

Pretendimin lidhur se OE “N.SH. M.V.R Elektromontuesi & NNP Elektro”, në ofertën e tij në shumicën e pozicioneve ka ofruar çmime manipulative dhe që nuk përkojnë me realitetin dhe çmimin në treg, PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar dhe konstaton se AK nuk ka zbatuar në përpikëri dispozitat e nenit 61 të LPP-së.

Paneli shqyrtues për pretendimet ankimore të OE ankues për OE “Anesi SH.P.K & Elektrostublla”:

Pretendimin rreth kontratave të punëtorëve teknik dhe fizik nuk janë të noterizuara PSH e klasifikon të pa bazuar sepse ky OE i ka ofruar marrëveshjet dhe janë dorëzuar dëshmitë konform kërkesës së vendosur tek FDT.

Pretendimin lidhur për kualifikimet shkollore, PSH e klasifikon si të pa bazuar dhe i mbështet arsyetimet e ekspertit për këtë pretendim dhe konsideron se OE në përputhje të plotë me kërkesat në FDT dokumentacionin dhe dëshmitë për stafin profesional dhe të pakualifikuar.

Pretendimin lidhur se OE “N.SH. M.V.R Elektromontuesi & NNP Elektro”, në ofertën e tij në shumicën e pozicioneve ka ofruar çmime manipulative dhe që nuk përkojnë me realitetin dhe çmimin në treg, PSH këtë pretendim e klasifikon të bazuar dhe konstaton se AK nuk ka zbatuar në përpikëri dispozitat e nenit 61 të LPP-së.

PSH, këtë ankesë të OE ankues e klasifikon si të bazuar për shkak se AK, nuk ka vepruar konform nenit 61 të LPP dhe lënda duhet të kthehet në ri-vlerësim. Kjo ankesë është klasifikuar e bazuar edhe pse shumicën e pretendimeve i ka të pa bazuara por me pretendimin sa i përket mos respektimit të nenit 61 të LPP nga ana e AK ka bërë që të ndryshohet epilogu përfundimtar ( anulimi i vendimit për dhënie të kontratës).

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet

juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Andaj, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Kryesues i Panelit e Shqyrtues**

Z. Vedat POTERQOI



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KOMUNA E PRISHTINËS;

1x1 OE- “TERMOMONTIMI SH.P.K”;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.